

P.nr.673/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** , me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. D. nga fsh. B. KK Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas Aktakuzave të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr.1358/16 të dt.31.10.2016, në shqyrtimin gjyqësor fillestar , të mbajtur më datë **06.03.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, perf. te autorizuar te dëmtuarës B. J. si dhe te akuzuarit M. D. te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M. D.** nga fsh. B. K Gjakova ,i biri i K. dhe i nënës F. e gjinisë D. i lindur me dt...., ka te kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 1 fëmije.

Ë s h t ë f a j t o r:**Sepse:****I.**

-nga data e pavërtetuar e gjerë me dt.08.07.2014, në fsh. B. K-Gjakovë, me qëllim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror , në mënyrë të kundërligjshme , ne kundërshtim me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike te R. Kosovës, ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne atë mënyrë jashtë njehsorit elektrik përmes kablllos 3x2.5 është lidhur direkt ne rrjetin elektrik duke u furnizuar ilegalisht me energji elektrike, duke pamundësuar kështu regjistrimin e sakte te energjisë elektrike te shpenzuar, me ç ‘rast ndërmarrjes se dëmtuar KEDS- divizioni ne Gjakovë i ka shkaktuar dëme ne shume prej 249.90 euro .

II.

-nga data e pavërtetuar e gjere me dt.19.12.2015,në fsh. B. K Gjakovë, me qellim qe vetes ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm, ne mënyrë të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike te R. Kosovës ,ka shfrytëzuar rrymën elektrike ne atë mënyrë qe përmes kablllos 3x2.5 është lidhur direkt ne rrjetin elektrik duke u furnizuar ilegalisht me energji elektrike duke pamundësuar kështu regjistrimin e sakte te energjisë elektrike te shpenzuar, me ç ‘rast ndërmarrjes se dëmtuar KEDS- divizioni ne Gjakovë i ka shkaktuar dëme ne shume prej 130.19 euro.

-me çka ka kryer vepër penale në vazhdimësi të vjedhjes se shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 te KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51, 52 par 5,73 ,neni 320-81 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4(katër) muajve** dhe dënim me gjobë ne shumë prej **200.00 (dyqind) euro, te** cilat dënime nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë ,ka ngritë aktakuzën PP.nr. 1358/16 të dt.31.10.2016, kundër të akuzuarit M. D. nga fsh. B. KK Gjakovë, për shkak te veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, në shqyrtimin fillestar me dt.06.03.2017, lexon aktakuzën PP.nr. 1358/16 të dt.31.10.2016 dhe deklaroj se mbetet në tërësi pran aktakuzës. Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike të pranimit të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme.

I akuzuari M. D. gjatë shqyrtimit fillestar ,duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, meqenëse një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët e KEDS-it ne njehsorin te cilën e shfrytëzojë qe disa vite, kërkojë falje nga e dëmtuara për demin e shkaktuar, premtroje se një veprim i tillë me nuk do te përsëritet ,mirëpo këtë vepër e kam kryer për shkak te gjendjes se varfër ekonomike, andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer, premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla, si dhe është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Perf. i autorizuar i te dëmtuarës B. J. sipas autorizimit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit por parashton kërkesën pasurore juridike.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari M. D. - **I.** -nga data e pavërtetuar e gjerë me dt.08.07.2014, në fsh. B. K- Gjakovë, me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror , në mënyrë të kundërligjshme , ne kundërshtim me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike te R. Kosovës, ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne atë mënyrë jashtë njehsorit elektrik përmes kabllos 3x2.5 është lidhur direkt ne rrjetin elektrik duke u furnizuar ilegalisht me energji elektrike, duke pamundësuar kështu regjistrimin e sakte te energjisë elektrike te shpenzuar, me ç ‘rast ndërmarrjes se dëmtuar KEDS- divizioni ne Gjakovë i ka shkaktuar dëme ne shume prej 249.90 euro. **II.**-nga data e pavërtetuar e gjere me dt.19.12.2015,në fsh. B. Gjakovë, me qellim qe vetes ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm ,ne mënyrë të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike te R. Kosovës ,ka shfrytëzuar rrymën elektrike ne atë mënyrë qe përmes kabllos 3x2.5 është lidhur direkt ne rrjetin elektrik duke u furnizuar ilegalisht me energji elektrike duke pamundësuar kështu regjistrimin e sakte te energjisë elektrike te shpenzuar, me ç ‘rast ndërmarrjes se dëmtuar KEDS- divizioni ne Gjakovë i ka shkaktuar dëme ne shume prej 130.19 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar

natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit, gjendjen e varfër ekonomike, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprat të tilla, si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të zbatojë dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së. Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve dhe dënimin me gjobë prej 200.00 (dyqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së, pasi që gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur të saktësojë lartësinë e dëmit që i akuzuari ia ka shkaktuar të dëmtuarit pasi që nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet në dispozitën e nenit 450/1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 673/16 më datë 06.03.2017.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.